

**20050811082**

**L I G J I**  
**PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA TE BANKA**  
**NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM-BANKA BOTËRORE SIPAS**  
**MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN PËR REFORMËN E**  
**RRUMBULLAKIMIT AFARIST DHE PËRFORCIMIT INSTITUCIONAL**

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore me hua në shumë prej 8.800.000 euro sipas marrëveshjes për hua, të dedikuar për realizimin e Projektit për reformën e rrumbullakimit afarist dhe përforcimit institucional.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për hua sipas Projektit për reformën e rrumbullakimit afarist dhe përforcimit institucional, e cila do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati për kthimin e huas nga neni 1 i këtij ligji është 17 vjet, me grejs periudhë prej 5 vitesh dhe kamatë vjetore me shkallë LIBOR +0,75%.

Huaja do të paguhet në 24 anuitete gjysmëvjetore duke filluar nga 15 tetori 2010 deri më 15 tetor 2021, do të paguhet 23 anuitete të barabarta gjysmëvjetore në shumë prej 365.000 euro dhe me 15 prill 2022 do të paguhet anuiteti i fundit në shumë prej 405.000 euro.

Në grejs periudhën prej 5 vjetësh, që paraqet edhe periudhën e realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Neni 4

Me ose menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për hua nga neni 2, paragrafi 1 i këtij ligji, paguhet provizion i njëhershëm - shpenzim në shumë prej 1% nga shuma e huas. Shuma e provizionit të njëhershëm mund të jetë edhe më e vogël se 1% në bazë të vendimit paraprak të miratuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore.

Shumës së mjeteve të patërhequra të huas i paguhet provizion në lartësi prej 0,75% në vit, të përcaktuar nga ana e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore.

Provizioni nga paragrafi 2 i këtij neni paguhet në gjysmëvjetor edhe atë më 15 tetor dhe më 15 prill çdo vit.

Neni 5

Për realizimin e Marrëveshjes për hua sipas Projektit për reformën e rrumbullakimit afarist dhe përforcimit institucional, kompetente është Ministria e Ekonomisë.

Shfrytëzues të huas sipas Projektit për reforma të rrumbullakimit afarist dhe përforcimit institucional nga paragrafi 1 i këtij neni përveç Ministrisë së Ekonomisë janë Regjistri Qendror dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

Ministria e Ekonomisë do të lidh marrëveshje për shfrytëzimin e pjesës së mjeteve të huas me Regjistrin Qendror dhe Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë.

Pas lidhjes së marrëveshjeve për shfrytëzimin e mjeteve të huas nga paragrafi 3 i këtij neni, shfrytëzues të fundit të mjeteve bëhen Regjistri Qendror dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

Shfrytëzuesit e mjeteve të huas nga paragrafi 2 dhe 4 të këtij neni duhet ta parashohin shfrytëzimin e planifikuar të mjeteve të huas në buxhetet e tyre vjetore për periudhën e plotë të implementimit të projektit.

#### Neni 6

Republika e Maqedonisë, pjesën e huas nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga mjetet e parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për Ministrinë e Ekonomisë.

Pagimin e pjesës tjetër të huas nga neni 1 i këtij ligji do ta bëjnë Regjistri Qendror dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë në pajtim me marrëveshjet për shfrytëzimin e mjeteve të huas nga neni 5 i këtij ligji.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.